


Ballina



Gazeta Express

18/02/2020 15:41

Me i fundit



SHBA, më shumë viktima nga COVID-19 sesa nga sulmet

Sherr masiv me armë dhe leva në Vorë, arrestohen 3 persona



Një ngjarje e rëndë është parandaluar mesditën e sotme në Vorë, aty ku disa persona ishin përfshirë në një sherr.

Sipas policisë njëri prej tyre qëlloi me armë zjarri, ndërsa dy përdorën sende të forta gjatë konfliktit, arrestohen tre në flagrancë.

Sekuestrohet në cilësinë e provës materiale 1 armë luftarake pistoletë, fishekë luftarak, si dhe një shufër metalike .

Njoftimi



Specialistët për Hetimin e Krimit në Komisariatin e Policisë Vorë, pas njoftimit të marrë për një konflikt të çastit në rrugën "Rinia", ku disa persona ishin konfliktuar me njëri – tjetrin dhe njëri prej tyre kishte qëlluar me armë zjarri, kanë bërë të mundur kapjen dhe prangosjen e shtetasit në tentativë për t'u larguar, duke mos iu bindur urdhrit të Policisë për të ndaluar, konkretisht:

L. B., 28 vjeç, banues në Vorë, i cili u arrestua për veprat penale "Armëmbajtja pa leje" dhe "Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik".

Arrestimi i tij u krye, pasi ky shtetas, në bashkëpunim edhe me shtetasit A. E. dhe G. SH, në rrugën "Rinia", në Vorë, kanë goditur me sende të forta shtetasit B. T., E. T. dhe R. T.

Në përfundim të veprimi u bë arrestimi në flagrancë edhe i shtetasve:

A.E., 29 vjeç, banues në Vorë, për veprat penale "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta" dhe "Plagosja e lehte me dashje";

G. SH., 32 vjeç, banues në Vorë, i cili u arrestua për veprat penale "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta" dhe "Plagosja e lehtë me dashje".

Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprime të mëtejshme.



Share Now



Tjera nga rubrika



Meta: Testimet për Covid-19 duhen shtuar për një panoramë më të qartë




Spasovski: Duhet të sigurojmë para plotësuese për Buxhetin



Meta njofton lehtësira të tjera ekonomike: Shpresoj të ketë një refleksim nga qeveria



Pendarovski: Shpresoj të gjejmë zgjidhje me Turqinë për respiratorët



A është testuar Rama për koronavirusin? Nano: Je kryeministri më i pafat!




Pamjet nga Kukësi, dëbora mbulon rrugët e boshatisura prej koronavirusit

From The Web



Play this Game for 1 Minute and see why everyone is addicted

StrategyCombat



The Cost of Hair Transplant in Dubai Might Actually Surprise You

Hair Transplant | Search Ads



23 People from History Who Look Exactly Like Today's Celebrities

Foodellicious



Te fundit



SHBA, më shumë viktima nga COVID-19 sesa nga sulmet e 11 Shtatorit



Pamje: Ronaldinho mposhtet në burg



Meta: Testimet për Covid-19 duhen shtuar për një panoramë më të qartë



Spasovski: Duhet të sigurojmë para plotësuese për Buxhetin



Haradinaj kundër zgjedhjeve të parakohshme



Meta njofton lehtësira të tjera ekonomike: Shpresoj të ketë një refleksim nga qeveria